



**NGRITJA  
E ZËRIT**

**Tel:** 044 195-113  
044 633-325  
**Adresa:** Rruga e UÇK-së,  
Skenderaj  
**Email:** info@ngritjaezerit.org  
**Web:** www.ngritjaezerit.org

## **GJYKATES KOMUNALE NE SKENDERAJ**

**PADITES: Halil Sejdiu** me vendbanim në f.sh. Prelloc, 41000 Skenderaj – Republika e Kosovës

**E PADITUR QEVERIA E REPUBLIKËS SE SERBISË BEOGRAD**, rr. e Nemanjës  
nr.11 11000 Beograd

### **PADI PËR KOMPENSIM DËMI**

#### **PROPOZIM PËR LIRIMIN NGA PAGIMI I SHPENZIMEVE PROCEDURALE**

( ne kuptim me nenin 7 te Udhëzimit Administrativ 2008/02te K.GJ. dhe nenit 468 .1 i Ligjit mbi Procedurën Kontestimore LIGJI Nr. 03/L – 006 )

**Objekt kontesti : Kompensimi dëmit**

**Vlera e kontestit : 626600€**

1.) Paditësi qysh ne vitin 1998 si rezultat i presionit dhe kërcënimeve nga forcat ushtarake serbe është detyruar ta braktis shtëpinë së bashku me 7 anëtarët familjes me datën 13.03.1999 , per tri net strehohet ne fshatin Likoc Komuna e Skenderajt, ndërsa për shkak te pasigurisë zhvendoset ne fshatin Tushilë tek Asllan Imeri aty qëndrojnë dy javë, nga aty shkojnë në fshatin kottor tek Xhafer Behrami aty qëndrojnë 3 javë, dhe nga aty shkojnë ne fshatin Braboniq Komuna e Mitrovicës te Osman Hajrizi ku qëndrojnë 25 dit dhe kthehen ne territorin e Komunës së Skenderajt ne fshatin Lubovec tek Hisni ferizi ku qëndrojnë 2 javë dhe nga aty detyrohen te gjithë ti braktisin shtepit dhe shkojn ne malet e Qyqavicës dhe qëndrojnë nenë tenda najloni deri ne përfundim te luftës.

Provë : - Kërkesa për kompensimin e dëmeve te luftës, nr.580-69 e datës 20.01.2009.  
- Deklarata e bashkësisë familjare nen numrin rendor 035-340 e datës 21 01.2009

2.) Paditësi si rezultati i veprimeve gjenocidiale ,krimeve kundër njerëzimit te ndërmarra nga forcat ushtarake dhe policore te udhëhequra direkt nga qeveria e Serbisë ka pësuar dëme materiale dhe jo materiale , është detyruar me dhunë ta braktis shtëpinë se bashku me 4 anëtarët tjerë të familjes , i është djegur dhe shkatërruar shtëpia tri kateshe me një sipërfaqe prej 180 m<sup>2</sup> si dhe oden ne siperfaqe prej 36 m<sup>2</sup>, ky shkatërrim nga ekspertet kompetent klasifikohet si dëmtim i kategorisë se pestë, dëmtime në interierin shtëpiak duke e përfshire tekniken e bardh dhe mobilerine nga 7 dhoma te gjumit, nuk ka mundur ta punoj token bujqësore për 2 vite, i ka humbur traktorit me pajisjet përcjellëse, vetura e tipit audi 80, mulliri elektrik, 2 motorrr sharra për dru i është djegur shtalla, plemja për ushqim te kafshëve, hamar me grurë, koshi me misër dhe ushqimi i baktise si ne kerkes.

Provë :- Kërkesa për kompensimin e dëmeve te luftës, nr.580-69 e dates 20.01.2009.  
- Certifikatat mbi te drejtat pronës së paluajtshme U1 – 72015058-00007 e dt

20.01/09

- Vërtetimi i Drejtorisë së Urbanizmit nr.325-18 i dt. 17.12.2008

- Pesë fotografi të shtëpisë së djegur

- Vërtetimi nga dy dëshmitar për posedimin e veturës së markës Audi Gls

Paditësi si rezultat i vendimit politik të marrur nga ana e Qeverisë së Serbisë është larguar nga marrëdhënia e punës pran Qendrës për Punë sociale në Skenderaj me datën 10.09.1992, ndërsa në të njëjtin vend punë kthehet me datën 15.08.1999, ndërsa pagën mujore sipas valutës në dinar të atëhershëm në kundërvlerë me DM thekson se e ka pas 2000DM

Prova : - Delarata në kërkesën për dëme të luftës, nr.580-69 e datës 20.01.2009.

- Vërtetimi i lëshuar nga QPS në Skenderaj nr.4598 i datës 01.10.2009

Dëgjimi i paditësit si dhe provave tjera të cilat paditësi do të prezantojë në seancat e shqyrtimit kryesor dhe në rast nevojë të caktohet edhe eksperti përkatës .

4.) Të drejtën për kompensim paditësi e bazon në :

- nenin 185 të LMD ( G.Z. e RSFJ , Nr. 29/78 ) në lidhje me nenin 180.1 të të njëjtit Ligj , me të cilin është parapare që për demet e shkaktuar ndaj pasurisë të personave fizik si rezultat i dhunës dhe terrorit , përgjegjës është „ Bashkësia shoqërore politike “ e në rastin konkret e paditura ka qenë e obliguar aktet e vrasjes , dhunës , terrorit , dëmtimit , asgjësimit dhe vjedhjes së pasurisë së paditëses të pengojë e jo të ndërmarr veprime të tilla kundër ligjore

- nenin 6 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut dhe neni 1 i protokollit të parë bashkëngjitur konventës

- nenin 14 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut

Paditësi propozon që kjo Gjykatë të caktoj shqyrtimin kryesor të çështjes , t'i shfrytëzojë informatat e duhura nga mjetet provuese të propozuara dhe

1.) pastaj të bien këtë :

### AKTGJYKIM

I. Aprovohet kërkesa paditësit Halil Sejdiu , me vendbanim në f.sh.Prellovc , 41000 Skenderaj Republika e Kosovës në tersi si e bazuar .

II. Obligohet e paditura Qeveria e Serbisë si pasardhës e juridike e e Qeverisë së me parshme që në emër të njetes tija kompensojë paditësit Halil Sejdiu demin material dhe jomaterial , duke ja paguar

- shumën prej 19 600 € për dhembjen shpirtërore dhe të munduarit , ndjekjes nga shtëpia , banimit në qiell të hapur dhe shtëpi të huaja
- shumën prej 50 000 € për shkak të pamundësisë së krenimit të festave fetare në shtëpi , vizitën dhe nderimin e varrezave , humbjes së kontaktit me farefis dhe të afërmit
- shumën prej 324 000 € për shtëpinë dhe oden e djegur dhe të shkatërruar
- shumën prej 15 500 € për interierin shtëpiak
- shumën prej \_\_\_\_\_ € për pamundësinë e shfrytëzimit të tokës për dy vite
- shumën prej 13 000 € për traktorin e grabitur me pajisjet percjllse si në kërkesë
- shumën prej 8 500 € për veturën, mullirin elektrik, 2 motorr-sharra dhe material saldues si në kërkesë
- shumën prej 166 000 DM në emër të pagës për 83 muaj duke filluar nga data e largimit nga marrëdhënia e punës me 10.09.1992 deri në punësimin e serishëm me datën 15.08.1999

- shumën prej 30 000€për; shtallën,plemen,hamarin me plot drith,pasul dhemiell,dy kosha me misër dhe ushqimin e kafshëve te djegur persisht si ne kërkesë .

, të gjitha këto me kamatën ligjore qe nga ngritja e padisë e deri me pagesën definitive , të gjitha në një afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimit , nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm .

Pala e paditur ti paguaj shpenzimet procedurale të kësaj çështje juridike afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimit , nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm .


2.) te bihet

#### Aktvendim

mbi miratimin e propozimit te paditësit në këtë çështje juridike mbi lirimin nga pagimi i taksave dhe i shpenzimeve tjera procedurale duke marr parasysh gjendjen e vështirë ekonomike , në kuptim menin 7 te Udhëzimit Administrativ të K.GJ. Nr. 2008/2 . dhe nenit 468 .1 i Ligjit mbi Procedurën Kontestimore LIGJI Nr. 03/L – 006 .

Skenderaj , me 03.05.2010

Paditësi



Halil Sejdiu

Shtojcë :

1. Kërkesa për kompensimin e dëmeve te luftes nr.580-
- 2 Vërtetimi i Drejtorisë së Urbanizmit nr.325-31 i dt. 12.01.2009
- 3 . Deklarata për bashkësinë familjare nen numrin rendor 035-1660 e datës 20 01.2009
- 4 . Certifikatat mbi te drejtat pronës së paluajtshme U1- 72015065-00 e dt. 12.01/09
5. Vërtetmi i leshuar nga Shoqata e te burgosurve politik,dega ne Skenderaj nr.
6. Libreza e anetarsise nr.23/70 i dates 12.10.2009
7. Dy fotografi te shtëpisë së djegur
8. Libreza e anetarsise nr.23/70
9. 4 kopje te padisë